

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE I VITIT
2023**

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
01	11.01.2023	Misioni ICOMOS / IUCN ishte në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut më 27-31 janar 2020 për të parë nga afër situatën me zonën e shpallur Trashëgimi natyrore kulturore botërore në liqenin e Ohrit. Misioni ka lënë disa rekomandime për të plotësuar palës shqiptare dhe asaj të Maqedonisë së Veriut. Më datë 1 shkurt 2023 pala shqiptare dhe ajo e Maqedonisë, do të duhet të paraqesin dokumentacionin ku duhet të jenë plotësuar të gjitha rekomandimet. <i>Sa prej këtyre rekomandimeve janë plotësuar dhe sa jo? Për cilat arsye nuk janë plotësuar?</i>	02.02.2023	Deleguar ministrisë kulturës dhe ministrisë turizmit.	E plotë	Pa tarifë
02	18.01.2023	1. VKM nr. 638 datë 05.10.2022 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128 datë 30.12.2020 te KM Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese	24.01.2023	Vënë në dispozicion përgj kërkueses.	E plotë	Pa tarifë

- | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | <p>ndërkombëtare të ndryshuara”.</p> <p>2. VKM nr. 670 datë 19.10.2022 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128 datë 30.12.2020 të KM Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare të ndryshuara”.</p> <p>3. VKM nr. 705 datë 04.11.2022 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet KM të RSH dhe Qeverisë së Republikës së Kazakistanit për përjashtimin e ndërsjelltë të kërkesave për viza.</p> <p>4. VKM nr. 715 datë 11.11.2022 “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128 datë 30.12.2020 të KM Për zbatimin nga RSH të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare të ndryshuara”.</p> <p>5. VKM nr. 718 datë 11.11.2022 “Për zbatimin nga RSH të rregulloreve të Këshillit të Bashkimit Evropian</p> | | | |
|--|--|--|--|--|--|

për vendosjen,
ndryshimin dhe
shfuqizimin e masave
shtrënguese
ndërkombëtare.

6. VKM nr. 738 datë
23.11.2022 “Për disa
shtesa në vendimin
nr. 1128 datë
31.12.2020 të KSH
“Për zbatimin nga
Republika e
Shqipërisë të
vendimeve të
Këshillit të
Bashkimit Evropian
për vendosjen,
ndryshimin dhe
shfuqizimin e masave
shtrënguese
ndërkombëtare, te
ndryshuara”.

7. VKM nr. 830 datë
19.12.2022 “Për disa
shtesa në vendimin
nr. 1128 datë
31.12.2020 të KSH
“Për zbatimin nga
Republika e
Shqipërisë të
vendimeve të
Këshillit të
Bashkimit Evropian
për vendosjen,
ndryshimin dhe
shfuqizimin e masave
shtrënguese
ndërkombëtare, te
ndryshuara”.

8. VKM nr. 877 datë
27.12.2022 “Për disa
shtesa në vendimin
nr. 1128 datë
31.12.2020 të KSH
“Për zbatimin nga
Republika e
Shqipërisë të
vendimeve të
Këshillit të
Bashkimit Evropian
për vendosjen,

		ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, te ndryshuara”.				
03	18.01.2023	A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse gjate vitit 2022? Nëse keni ofruar mbështetje financiare cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim). Sa OJF kane aplikuar për mbështetje financiare gjate vitit 2022? Ju lutem specifikoni sipas formës se mbështetjes nëse ka patur me shume se një forme? Sa OJF kane përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem specifikoni sipas formës se mbështetjes nëse ka patur me shume se një forme? Cili ka qene buxheti i disbursuar për organizate dhe ne total? Ju lutem specifikoni sipas formës nëse ka pasur me shume se një forme? Keni ofruar mbështetje jo financiare gjate vitit 2022? Cila është baza ligjore/rregullatore qe rregullon këtë forme mbështetje? Nëse keni ofruar mbështetje financiare sa OJF kane përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qene lloji i mbështetjes jo financiare te ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash). Sa është numri i	07.02.2023	Ne përgjigje Tuajës, MEPJ disponon informacionin si vijon: 8. MEPJ ka realizuar tre konsultime publike në vitin 2022. Më shumë informacion është i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik. 9. MEPJ ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. 11. Ka marrë pjesë vetëm një OJF në njërin nga konsultimet publike. 12. Projekt aktet e hartuara nga MEPJ janë kryesisht akte individuale e administrative, si dhe akte që lidhen me marrëveshjet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, ndaj në përputhje me ligjin nr.146/2014 përjashtohen nga procesi i konsultimit. Projekt aktet që i nënshtrohen procesit, publikohen elektronikisht në RENJKP për tu konsultuar nga të gjitha palët e interesuara.	E plotë	Pa tarifë

		<p>konsultimeve publike te realizuara nga institucioni juaj gjate vitit 2022? A ka institucioni juaj koordinator per njoftimin dhe konsultimin publik? A ka institucioni juaj koordinator per shoqerine civile? Nese po, ju lutem citoni kontaktin. Sa OJF kane marre pjese ne konsultime publike te organizuara nga institucioni juaj? Sa per qind e projektligjeve/akteve nenligjore te hartuara nga institucioni juaj jane si rezultat i konsultimeve me OJF-te? A jane te perfshire perfaqesues te ojf-ve ne organe keshillore te institucionit tuaj? Nese po cilat jane keto organe keshillimore dhe sa OJF jane te perfshire ne to? A jane perfshire OJF ne grupet e punes se ngritura te institucionit tuaj? Nese po, cilat jane keto grupe pune dhe sa OJF jane te perfshire ne to? A eshte trajnuar stafi juaj mbi veprimtarine dhe funksionimin e OJF-ve? Nese po, sa punonjes jane trajnuar? A ka licencuar institucioni juaj OJF qe ofrojne sherbime te caktuara? Nese po, sa ojf jene licensuar? Per cfare sherbimesh jane licensuar?</p>				
04	25.01.2023	A eshte kontaktuar MEPJ nga okb per rastin e dyshuar per trafikim te	08.02.2023	Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme ka marre informacion nepermjet	E plotë	Pa tarifë

anijes KUIN 2275 ton karburant bruto të dërguar nga Libia drejt Shqipërisë.
A jemi në ketë rast përballe një shkelje të embargos të vendosur nga okb për eksportin e naftës bruto nga Libia?
A jeni vendosur në dijeni nga organet përgjegjëse?

burimeve diplomatike nga vendet partnere se anija - cisternë e lartpërmendur “Queen Majeda”, që ishte nisur nga Porti i Benghazi në Libi, drejt Portit të Durrësit, ka qenë duke transportuar naftë të dyshuar si kontrabandë. Ky informacion iu përcoll menjëherë autoriteteve tona ligj-zbatuese që e shoqëruan anijen në Portin e Durrësit. Strukturat përgjegjëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara u interesuan për hetimin e kësaj çështjeje. Më konkretisht, pas bllokimit të anijes, ndalimit të ekuipazhit dhe fillimit të procesit hetimor nga organet ligj-zbatuese shqiptare, Paneli i Ekspertëve të Kombeve Bashkuara, që merret me këqyrjen e zbatimit të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ndaj Libisë, i drejtoi një kërkesë Qeverisë Shqiptare që të zhvillonte një vizitë në Shqipëri për të zhvilluar takime me këto institucione ligj-zbatuese dhe intervistuar ekuipazhin e ndaluar.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mundësoi të gjitha takimet e kërkuara nga Paneli i Ekspertëve, por, sipas procedurës së panelit, nuk mund të ishte pjesë e këtyre takimeve. Bashkëpunimi i institucionit tonë me Panelin e Ekspertëve të OKB-së ka qenë

				<p>maksimal.</p> <p>A jemi në këtë rast përballë një shkelje të embargos të vendosur nga OKB për eksportin e naftës bruto nga Libia?</p> <p>Sipas informacioneve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, çështja është ende në hetim nga autoritetet tona ligj-zbatuese dhe vlerësojmë se duhet të priten rezultatet e hetimit.</p> <p>A jeni vendosur në dijeni nga organet përgjegjëse?</p> <p>Institucionet ligj-zbatuese janë treguar mjaft bashkëpunuese për pritjen e Panelit të Ekspertëve. Ende nuk jemi të informuar për rezultatet e takimeve të tyre me Panelin e Ekspertëve.</p>		
05	25.01.2023	Ne javën e dyte te janarit ka qarkulluar një video ku pretendohet se është keqtrajtuar nga policia e malit te zi një shtetas shqiptar i identifikuar si P.M ju lutem A keni pasur komunikim me palën malaze për ngjarjen nëse po ca reagimi ka pasur nga ana e shtetit shqiptare.	31.01.2023	<p><i>Në përgj të kërkesës Tuaj, ju bëjmë me dije si vijon; Ambasada jone ne Malin e Zi informon se në datën 16 janar 2023, nga burime konfidenciale në vendngjarje, është njoftuar se në PKK të përbashkët Sukhobin/Murriqan, konkretisht brenda territorit malazez, ka ndodhur një incident i dhunshëm me një shtetas shqiptar (i identifikuar nga ana e jonë si Z. P. M.), i cili është keqtrajtuar nga një oficer i policisë kufitare malazeze (i identifikuar nga ana e jonë si oficeri Dragan Scekcic).</i></p>	E plotë	Pa tarifë

Më tej, në njoftimin e Ambasadës tonë në Mal të Zi, thuhet se pas këtij njoftimi të besueshem, Ambasada ka kontaktuar shtetasin e përfshirë, dhe të keqtrajtuar duke siguruar marrjen e informatave dhe versionin e tij lidhur me ngjarjen.

Ambasada njofton gjithashtu se përsa më lartë shtetasi shqiptar nuk ka bërë denoncim me shkrim, as pranë autoriteteve malazeze dhe as pranë autoriteteve tona në PKK Murriqan.

Pasi ka konstatuar sa më lart, Ambasada jonë ka marrë menjëherë kontakte direkte me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, z. Zoran Berzhanin si dhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Qeverisë, z. Ilir Harasani.

Në këto komunikime, Ambasada jonë ka kërkuar identifikimin e menjëhershëm të oficerit dhunues dhe marrjen e masave të nevojshme administrative për të dënuar dhe për të penalizuar oficerin apo oficerët e përfshirë në këtë incident të pakëndshëm dhe të dënueshëm.

Pa vonesë, Drejtoria e Përgjithshme Policisë në Podgoricë ka identifikuar oficerin e përfshirë në këtë incident dhe i ka kërkuar drejtuesit të PKK Sukhobin informacion me

shkrim mbi rrjedhën e incidentit.

Me tej, Ambasada jonë bën me dije, se Drejtoria e Shërbimit të Brendshëm në Policinë e Shtetit në Podgoricë ka iniciuar procesin e hetimit policor për Dragan Scekić, oficer i policisë kufitare të PKK Sukhobin, për rastin në fjalë dhe për raste të tjera eventuale të mëparëshme.

Ne vijim, njoftimi për fillimin e procesit hetimor policor është pasqyruar edhe në mediat dhe portalet vendase pas deklaratës së DP të Policisë (CDM, data 17/1/23).

Në datën 23 janar 2023, Ambasadori ynë në Mal të Zi, z.Ridi Kurtezi ka marrë takim në MPJ në Podgoricë me Sekretarin e Përgjithshëm të MPJ, z. Robert Markić ku dhe ka vlerësuar angazhimin e zyrtarëve të lartë malazez dhe faktin që oficeri është dërguar për hetim policor.

Ambasadori ynë ka kërkuar marrjen e masave administrative për të dënuar dhe për të penalizuar çdo oficer policie që bëhet protagonist i incidenteve të pakëndshme.

Zyrtari ka shprehur besim në procesin hetimor policor të iniciuar për oficerin malazez dhe ka dënuar rastin në fjalë dhe raste të ngjashme.

				<p>Ambasada është në kontakt të vazhdueshëm me shtetasin P. M., i cili në cdo rast ka shprehur mirënjohje për angazhimin dhe përfshirjen e ambasadës në këtë çështje, dhe prezantimin e saj përpara autoriteteve malazeze.</p>		
06	01.02.2023	<p>1- Një kopje të plotë të kontratës së nënshkruar ndërmjet Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”, referuar vendimit të të Këshillit të Ministrave nr.115, datë 23.02.2018 .</p> <p>2- Në rast se kontrata është klasifikuar sekret, një kopje të urdhit të lëshuar nga titullari për ngritjen e "Komisionit të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar" për klasifikimin e kontratës së nënshkruar, ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”, si sekret shtetëror referuar VKM Nr. 123 date 15. 3. 2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”.</p> <p>3- Një kopje të procesverbalit të mbledhjes së kryer nga "Komisionit i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar" për klasifikimin e kontratës së nënshkruar, ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe</p>	13.02.2023	<p>Në përgjigje te kërkesës tuaj Sqarojmë si vijon:</p> <p>Me kërkesën e datës <u>17.06.2019</u> në cilësinë e gazetares së OCCRP keni bërë kërkesë pranë MEPJ-së për të <u>njëjtin objekt kërkesë</u>, për të cilën kemi kthyer përgjigje se VKM nr. 115/2018 si dhe çdo akt tjetër në zbatim të saj është një dosje e klasifikuar në mbështetje të ligjit nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, si rrjedhojë gjen mbështetje në dispozitat kufizuese të Kreu IV neni 17.të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Bazuar në pikën 12, të VKM-së 123, datë 15.3.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikuar të sekretit shtetëror” të cilën referoni (në fuqi në atë kohë) shprehej si vijon: <i>12. Kur një informacion është klasifikuar, e gjithë praktika ku bën pjesë ai të klasifikohet në nivelin e këtij informacioni.</i> Për sa me siper referuar</p>	E plotë	Pa tarifë

		<p>Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO ËORLDËIDE”, si sekret shtetëror referuar VKM Nr. 123 date 15. 3. 2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”.</p> <p>4- Një kopje të raporti të mbledhjes së kryer nga "Komisionit i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar” ku argumentohen arsyet për klasifikimin e kontratës së nënshkruar, ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO ËORLDËIDE”, si sekret shtetëror referuar VKM Nr. 123 date 15. 3. 2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror”.</p>		<p>praktikës në të cilin është realizuar kontrata, rezultojnë dokumente ligjore të klasifikuara të cilat përmbajnë klauzola detyruese për kontratën; për rrjedhojë edhe kontrata mban të njëjtin nivel klasifikimi.</p> <p>Gjendur në të njëjtat kushte bëjmë me dije se informacioni që kërkoni nuk mund t ju vihet në dispozicion.</p>		
07	06.02.2023	<p>Mbi çfarë bazash vlerësimi qeveria shqiptare mori vendimin për heqjen reciproke të vizave me Republikën Popullore të Kinës.</p>	13.02.2023	<p>Republika e Shqipërisë nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare, në zbatim të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p><i>Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për heqjen reciproke të vizave për mbajtësit e pasaportave të zyrtarëve publikë dhe të pasaportave të zakonshme, pas shprehjes së interes nga pala shqiptare (dakordësuar kjo në nivel politik) është</i></p>	E plotë	Pa tarifë

			<p>propozuar, hartuar, dakordësuar dhe lidhur në zbatim të ligjit nr. 43/2016, konkretisht:</p> <p>Nenit 8 që lidhet me bashkërendimin dhe dakordësimin e tekstit të marrëveshjes</p> <p>Neni 9 dakordësimi i tekstit me palën kineze</p> <p>Neni 10 miratimi në Këshill të Ministrave i tekstit para nënshkrimit</p> <p>Nenet 5 dhe 15 sipas të cilëve marrëveshja është nënshkruar nga zyrtarët e autorizuar për nënshkrimin e saj</p> <p>Pas nënshkrimit teksti i marrëveshjes është dërguar për miratim përfundimtar në Këshill të Ministrave, në përputhje kjo me nenin 19.</p> <p>Kujtojmë se lidhja e kësaj marrëveshjeje ka ardhur si nevojë e respektimit të parimit të reciprocitetit mes palëve, pasi shtetasve kinezë në mënyrë të njëanshme, u është lejuar hyrja pa viza në territorin e Shqipërisë, me vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>			
08	14.02.2023	Informacione për reformat që duhet të plotësohen për arritjen e acquisit dhe hyrjes të Shqipërisë në BE.	17.02.2023	Deleguar përfaqësuesve te kryenegociatorit.	E plotë	Pa tarifë

09	20.02.2023	<p>VKM nr. 10 date 11.01.2023 “Për disa shtesa ne vendimin nr. 1128 date 30.12.2020 te KM Për zbatimin nga RSH te vendimeve te Këshillit te Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare te ndryshuara ”</p> <p>VKM nr. 14 date 18.01.2023 “Për disa shtesa ne vendimin nr. 1128 date 30.12.2020 te KM Për zbatimin nga RSH te vendimeve te Këshillit te Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare te ndryshuara ”.</p> <p>VKM nr. 15 date 18.01.2023 “Për mbylljen e misionit të posaçëm të Republikës se Shqipërisë ne Kiev Ukraine”.</p> <p>VKM nr. 16 date 18.01.2023 “Për hapjen e misionit diplomatik te Republikës se Shqipërisë ne kryeqytetin e Ukrainës, Kiev”.</p> <p>VKM nr. 51 date 01.02.2023 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë se Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunimin në fushën e diasporës”</p> <p>VKM nr. 52 datë</p>	03.02.2023	Vënë në dispozicion përgjigjia kërkuarës.	E plotë	Pa tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-----------

		01.02.2023 VKM “Për një shtesë në vendimin nr. 718 datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave”Për listën e personave të shpallur si financues se terrorizmit, të ndryshuar”.				
10	22.02.2023	Kopje te aktit ligjor me te cilin është hequr vula apostile për dokumentet zyrtare midis Shqipërisë dhe Kosovës.	28.02.2023	Në përgjigje të kërkesës Tuaj gjeni bashkëlidhur kopjen e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave te Republikës se Shqipërisë dhe Qeverise se Republikës se Kosovës për Ndihme te Ndërsjellët Juridike ne Çështjet Civile dhe Tregtare. Për dijeni, marrëveshja ka hyre ne fuqi e është ne zbatim qysh me 30 qershor 2022, e ne nenin 14 te saj përcaktohet përjashtimi nga detyrimi për legalizim/apostilim i dokumenteve.	E plotë	Pa tarifë
11	02.03.2023	Kopje te marrëveshjes se firmosur sot ne Podgorice midis Republikës se Shqiperise dhe Malit te Zi mbi ndërtimin e urës ne lumin e Bunes	10.03.2023	Në vijim të kërkesës tuaj bashkëlidhur do të gjeni kopjen e nënshkruar të “Marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana”, nënshkruar në Podgoricë, me 27.02.2023. Në përputhje me nenin 12 të marrëveshjes, pritët përfundimi i procedurave të brendshme ligjore nga Palët për hyrjen e saj në fuqi.	E plotë	Pa tarifë
12	06.03.2023	Kërkesë e deleguar nga koordinatori KM mbi kontratën me kompaninë “Ernst Young”	13.03.2023	Ne përgjigje tuajes ne lidhje me kërkesën për informacion te deleguar nga Koordinatori KM ju bëjmë me dije se MEPJ nuk ka dijani për	E plotë	Pa tarifë

				kontratën me kompaninë “Ernst Young”		
13	08.03.2023	Sa është vlera e donacioneve monetare që Shqipëria ka dhuruar për shtetin Turk pas tërmetit të ndodhur muajin e kaluar (shkurt 2023) Kur ka përfunduar dhurimi i kësaj vlere? Sa përqind të buxhetit të shtetit përbën vlera e dhuruar Turqisë?	13.03.2023	Deleguar min Financës për kompetencë	E plotë	Pa tarifë
14	08.03.2023	<p>Numrin e qytetarëve të proceduar, dënuar ose ndaluar për falsifikim dokumentesh me qëllim emigrimin jashtë vendit në 8 vitet e fundit.</p> <p>Numrin e qytetarëve shqiptarë të proceduar, dënuar, ose ndaluar për tentativë të emigrimit të paligjshëm nga vendet e Europës drejt Mbretërisë së Bashkuar në 8 vitet e fundit.</p> <p>Numri i qytetarëve të deportuar nga Mbretërisa e bashkuar, specifikuar sipas viteve nga 2005 deri në 2022 dhe 2 muajt e parë të 2023.</p> <p>Të dhëna mbi numrin e trafikantëve (person i cili kalon shtetasit shqiptar drejt vendeve të Europës dhe Mbretërisë së Bashkuar në mënyrë të paligjshme kundrejt pagesës) të ndaluar ose dënuar gjatë 8 viteve të fundit.</p> <p>Numri i qytetarëve shqiptarë që kanë emigruar në 10 vitet e fundit të ndarë</p>	15.03.2023	Deleguar ministrisë së Brendshme	E plotë	Pa tarifë

		sipas viteve dhe shteteve pritëse.				
15	15.03.2023	A ka një prononcim nga Ministria e Jashtme shqiptare lidhur me rastin e keqtrajtimit të shtetasit shqiptar S.P nga kater pjesetare te policise greke, nje rast i pasqyruar gjeresisht, si ne median shqiptare dhe ate greke?	17.03.2023	<p>Sa i përket, çështjes së shtetasit shqiptar S. Z dhe keqtrajtimit të tij nga forca të policisë greke,</p> <p>Përfaqësia jonë në Athinë informon se ka marrë kontakte fillimisht me Ministrinë për Mbrojtjen e Qytetarit lidhur me këtë çështje duke u informuar se:</p> <p><i>"Nga Shërbimi i Punëve të Brendshme të Forcave të Sigurisë, katër policë u arrestuan në vendngjarje të shtunë, 11 mars 2023, të akuzuar për torturë dhe fyerje të një të burgosuri në bashkëpunim. Të arrestuarit janë dërguar në prokurorinë kompetente."</i></p> <p>Më tutje, Ambasada jonë në Athinë ka intensifikuar kontaktet me palën greke, edhe nëpërmjet Konsullit z. Vasili, i cili menjëherë ka kontaktuar Drejtorinë e Burgut të Koridhalosë, duke u informuar se:</p> <p><i>"Ngjarja nuk ka ndodhur në këtë institucion, por gjatë transferimit të tij në këtë burg. Menjëherë janë marrë masat për stabilizimin e situatës së krijuar dhe shtetasi shqiptar është trajtuar nga ana mjeksore dhe ndodhet në kushte normale në këtë institucion".</i></p> <p>Më tutje, Konsulli z. Vasilli ka komunikuar direkt me z. Z, duke i siguruar komunikim të drejtëpërdrejtë dhe mbështetje. Z. Z i ka</p>	E plotë	Pa tarifë

			<p>konfirmuar atij se ndihet i sigurtë në ambientet e burgut dhe nuk ka asnjë pakënaqësi lidhur me autoritet e këtij insitucioni.</p> <p>Në këtë kontekst, Ambasadorja jonë e akredituar në Greqi, znj.L.. ka zhvilluar më datë 14.03.2023 një takim me zv. Ministrin për Mbrojtjen e Qytetarit z. E. O., përgjegjës për policinë greke, të cilit i ka shprehur shqetësimin e palës tonë lidhur me këtë ngjarje.</p> <p>Nga ana e tij, zv. Ministri grek ka shprehur keqardhjen për ngjarjen duke dënuar dhunën e ushtruar nga policët grekë, duke shtuar se <i>"Nga ana jonë reagimi ka qënë i menjëhershëm dhe janë marrë të gjitha masat. Shërbimi i Punëve të Brendshme të Forcave të Sigurisë ka arrestuar policët dhe aktualisht ata po përballen me drejtësinë. Policët e akuzuar nuk janë më pjesë e stukturave të policisë greke për shkak të kësaj ngjarjeje".</i></p> <p><i>Zv. Ministri grek e ka siguruar Ambasadoren Hajdaraga se ky është një rast sporadik ndaj të cilit po merren të gjitha masat në mënyrë që mos të ketë përsëritje në të ardhmen.</i></p> <p>Ambasada me strukturat e saj mbetet në ndjekje të ngjarjes.</p>			
16	15.03.2023	Ju lutem na vini në dispozicion: Listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi	17.03.2023	Në lidhje kërkesën për informacion sa i takon listës së targave të automjeteve ekzistuese	E plotë	Pa tarifë

të institucionit tuaj.

në pronësi të institucionit tuaj, ju bëjmë me dije si vijon:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është institucion publik i rëndësisë së veçantë, përgjegjëse për veprimtarinë kryesore të RSH-së në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe Organizatat Ndërkombëtare. Referuar Ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, **siguria kombëtare është**

mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues, jetës dhe mirëqenies së qytetarëve, pasurisë kombëtare dhe **marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë.**

Pjesë e fushës së përgjegjësisë së MEPJ-së është veprimtaria protokollare e shtetit e rregulluar me VKM nr. 420, datë 8.6.2016 “Për miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë”. Në ushtrimin e kësaj veprimtarie, institucioni përdor aktivet (automjetet) për të realizuar lëvizjen, shoqërimin, transportin e delegacioneve dhe zyrtarëve gjatë takimeve dy ose shumëpalëshe.

Gjithashtu, referuar VKM-së 502, datë 23.06.2010 “Për miratimin e rregullores “Për transportimin fizik të informacionit të

				<p>klasifikuar “sekret shtetëror”, transportimi i objekteve dhe pakove postare të klasifikuara “sekret shtetëror” ndërmjet institucioneve shtetërore brenda qytetit, <u>kryhet me mjetet dhe personelin e cdo institucioni.</u> Ai kryhet nga korrieri, i postës së klasifikuar “sekret shtetëror”, i institucionit, dhe shoferi i automjetit pasi kanë marrë më parë certifikatën e sigurisë.</p> <p>Nisur nga këto rrethana, vlerësojmë se dhënia e informacionit <i>krijon potencialisht kushte për cenimin e sigurisë dhe mbarëvajtjes së aktivitetit të institucionit.</i> Referuar nenit 17 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, paragrafi 2, gjerat a dhe ë, informacioni i kërkuar nuk mund t’ju vihet në dispozicion.</p>		
17	30.03.2023	<p>Kërkohet informacion:</p> <p>1. A ka Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme një databazë për të miturit që janë regjistruar të humbur nga vendet e BE-së?</p> <p>2. Sa është numri i të miturve (0-18 vjeç) shqiptarë që kanë rezultuar të humbur gjatë gjatë periudhës 1 janar 2021-1 janar 2022 në vendet e Bashkimit Evropian?</p> <p>3. Sa është numri i të miturve (0-18 vjeç) shqiptarë të regjistruar të humbur në vendet e BE-së gjatë periudhës 1 janar 2022-1 janar 2023?</p>	03.04.2023	Deleguar Ministrisë së Brendshme	E plotë	Pa tarifë

		4. A ka prej tyre që janë rigjetur dhe janë kthyer në atdhe? Nëse po, cilës grupëmoshe i përkasin kryesisht?				
18	31.03.2023	<p>Kërkesë për informacion:</p> <p>1. Sa është numri i “të sinjalizuarëve” në organizatën tuaj, gjatë pesë viteve të fundit (2018;2019; 2020; 2021; 2022) dhe në secilin prej viteve të mësipërme?</p> <p>2. Cila është struktura e njësisë përgjegjëse (numri i anëtarëve të kësaj strukture; formimi, statusi dhe niveli përfaqësues administrativ i anëtarëve të saj) që regjistron, shqyrton dhe inspekton procedurat e hetimit administrati të nisura për shkak të sinjalizimeve të marra nga sinjalizuesit, si dhe hetimet për mbrojtjen e sinjalizuesve, brenda autoritetit publik; mbi ç’kriterë është bërë përzgjedhja dhe funksionimi i njësive përgjegjëse?</p> <p>3. Sa sinjalizime të brendshme janë regjistruar në organizatën tuaj, gjatë periudhës në</p>	05.04.2023	<p>1: Për periudhën 2018-2022 nuk ka ndonjë numër të përcaktuar të sinjalizuesve apo të sinjalizuarve pasi nuk ka pasur sinjalizime</p> <p>2: Në zbatim të LigjitNr.60/2016 “ Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve », si një mjet i rëndësishëm antikorrupsion. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me urdhërin e Ministrit nr.456, datë 25.04.2016 ka ngritur Njësinë Përgjegjëse si organi i posaçëm, i përbërë nga dy punonjës (drejtuesin e njësive së auditimit të brendshëm dhe një specialiste të kësaj drejtorie) dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të ligjit.</p> <p>3: Nuk ka pasur sinjalizime për periudhën.</p> <p>4: Nuk ka pasur sinjalizime gjatë periudhës, për pasojë nuk ka pasur raste të konfliktit të interesit nga antarët e njësive përgjegjëse.</p> <p>5: Në zbatim të Ligjit Nr.60/2016 “ Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve “pika 10, Neni 13, ku citohet “Çdo organizatë, sipas udhëzimeve të ILDKPKI-së, dhe ILDKPKI-ja,</p>	E plotë	Pa tarifë

		<p>fjalë?</p> <p>4. A ka pasur rast kur anëtarët e njësisë përgjegjëse kanë deklaruar se kanë qënë në kushtet e konfliktit të interesit, përpara fillimit të hetimit administrativ për shkak të një sinjalizimi? Nëse po, në ç'rrethana ka ndodhur; si është proceduar më tej, pas deklarimit?</p> <p>5. Kopje e plotë e rregullores lidhur me zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit.</p> <p>6. Sa është numri i hetimeve administrative të kryera pas marrjes së sinjalizimeve; numri inspektiveve të kryera nga njësia përgjegjëse në kuadrin e hetimeve administrative të filluara?</p> <p>7. Sa prej hetimeve administrative të kryera në kuadrin e një sinjalizimeve kanë rezultuar në shkelje administrative?</p> <p>8. Sa është numri i sinjalizimeve të cilat nuk janë depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së</p>	<p>miratojnë rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, sipas këtij ligji“, Njësia Përgjegjëse në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka hartuar rregulloret si më poshtë :</p> <p>1. Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në MEPJ.</p> <p>2. Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në MEPJ.</p> <p>Rregulloret janë miratuar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse. Rregulloret janë të publikuara në faqen e internetit të MEPJ .</p> <p>6: Nuk ka pasur hetime administrative pasi nuk ka pasur sinjalizime.</p> <p>7: Nuk ka pasur hetime administrative për pasojë nuk janë evidentuar edhe shkelje administrative.</p> <p>8: Nuk ka pasur sinjalizime për pasojë nuk janë evidentuar edhe raste të përmendura në pyetjen me lart.</p> <p>9: Nuk ka pasur raste te tilla.</p> <p>10: Nuk ka pasur raste te tilla.</p> <p>11: Për çdo vit nga Njësia Përgjegjëse janë dërguar raporte apo informacion</p>		
--	--	--	---	--	--

		<p>kërkuar nga legjislacioni (60/2016); ose nuk kanë pasur elemente të kundravajtjes administrative ose të veprës penale?</p> <p>9. Sa është numri i sinjalizimeve të bazuara, të cilat i keni referuar në prokurori apo në Policinë e Shtetit?</p> <p>10. Sa është numri i kërkesave për mbrojtje nga ana e sinjalizuesve, të cilët pretendojnë se janë, apo kanë qënë, subjekt i një akti hakmarrjeje? A janë kryer hetime administrative ndaj këtyre pretendimeve?.</p> <p>11. Kopje të raporteve vjetore të njësive përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.</p>		<p>pranë ILDKPKI lidhur me veprimtarinë e kësaj njësie. Kopje të shkresave dërguar ILDKPKI bashkëngjitur .</p> <p>Në vijim të kërkesës tuaj bashkëlidhur do të gjeni dokumentat e kërkuara.</p>		
19	05.04.2023	<p>Kërkesë për informacion për vënie në dispozicion të dokumenteve zyrtare "Relacion Shpjegues" të VKM-ve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, gjatë vitit 2023, me propozim të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.</p>	11.04.2023	Vënë në dispozicion përgjigjia kërkuases.	E plotë	Pa tarifë
20	07.04.2023	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me një emërim në Konsullatën Shqiptare në Stamboll të shtetases J. H. Informacion sa më të</p>	14.04.2023	<p>Referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Znj. J. H, është emëruar në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të</p>	E plotë	Pa tarifë

detajuar në lidhje me emërimin e saj, procedurën e rekrutimit, kush e ka bërë përzgjedhjen dhe si u zgjodh për të shkuar në Turqi.

Republikës së Shqipërisë”, neni 31, pika 3, ku parashikon emërimin për nevoja të veçanta diplomatike të ekspertëve jashtë shërbimit të jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit.

Në jetëshkrimin e paraqitur pranë MEPJ-së rezulton se shtetësja në fjalë plotëson të gjitha kushtet, sipas së cilës ka përfunduar studimet e larta jashtë vendit për marrëdhënie ndërkombëtare, zotëron tre diploma të nivelit Master dhe ka një përvojë të gjerë në mësimdhënie, gazetarie dhe botën akademike. Për më tepër znj. J. H. e cila është lindur e rritur në familje diplomatësh, ku zotëron njëkohësisht shkëlqyer katër gjuhë të huaja, ndër të cilat edhe gjuhën turke.

Bazuar mbi këto kritere e cilësi është bërë fillimisht emërimi i saj në Konsullatën e Përgjithshme të RSH në Stamboll.

Në kuadër të transparencës, theksojmë se sipas dokumenteve zyrtare (certifikatë familjare) znj. J. H. rezulton e pamartuar.

Pas emërimit, ajo nuk e ka marrë detyrën, pasi gjatë kësaj periudhe ka qenë në proces verifikimi, në përputhje me ligjin.

Informojmë se gjatë këtij procesi verifikimi, znj. J. H. i ka kërkuar Drejtorisë

				<p>së Burimeve Njerëzore në MEPJ të tërhiqet, për arsye personale.</p> <p>Në përfundim ju bëjmë me dije se Znj. J. H. nuk ka shërbyer asnjë ditë në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, si dhe nuk është pajisur me pasaportë diplomatike dhe nuk ka gëzuar për asnjë moment imunitetet dhe privilegjet që të jep statusi i diplomatit. Rrjedhimisht nuk ka patur asnjë komunikim me autoritetet turke për këtë emërim.</p>		
21	10.04.2023	<p>Kërkohet informacion lidhur me shtetasen shqiptare J. H.</p> <p>1- A është kjo shtetase e punësuar pranë institucionit tuaj, apo një përfaqësie diplomatike në varësi të institucionit tuaj. Nëse po, ku?</p> <p>2- A është emëruar ajo së fundmi në ambasadën e Shqipërisë në Turqi, madje duke u pajisur me pasaportë diplomatike?</p> <p>3- A jeni në dijeni se ajo është bashkëshortja e R.K., i kërkuar ndërkombëtarisht me urdhër arrest prej vitit 2020 në Gjermani për trafik droge e pasuri parash?</p> <p>4- A jeni në dijeni se J. H. është bashkëshortja e R.K., madje këtij të fundit iu sekuestruan pasuritë nga SPAK gjatë këtij viti në Shqipëri?</p> <p>5- Cilat janë kriteret për emërimet nga MEPJ, a ka një filtër për trupën diplomatike?</p>	14.04.2023	<p>Referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Znj. J. H, është emëruar në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, neni 31, pika 3, ku parashikon emërimin për nevoja të veçanta diplomatike të ekspertëve jashtë shërbimit të jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë, sipas specifikave të pozicionit të emërimit.</p> <p>Në jetëshkrimin e paraqitur pranë MEPJ-së rezulton se shtetësja në fjalë plotëson të gjitha kushtet, sipas së cilës ka përfunduar studimet e larta jashtë vendit për marrëdhënie ndërkombëtare, zotëron tre diploma të nivelit Master dhe ka një përvojë të gjerë në mësimdhënie, gazetarie dhe botën akademike. Për më tepër znj. J. H, e cila është lindur e rritur</p>	E plotë	Pa tarifë

në familje diplomatësh, ku zotëron njëkohësisht shkëlqyer katër gjuhë të huaja, ndër të cilat edhe gjuhën turke.

Bazuar mbi këto kritere e cilësi është bërë fillimisht emërimi i saj në Konsullatën e Përgjithshme të RSH në Stamboll.

Në kuadër të transparencës, theksojmë se sipas dokumenteve zyrtare (certifikatë familjare) znj. J. H. rezulton e pamartuar.

Pas emërimit, ajo nuk e ka marrë detyrën, pasi gjatë kësaj periudhe ka qenë në proces verifikimi, në përputhje me ligjin.

Informojmë se gjatë këtij procesi verifikimi, znj. J. H. i ka kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në MEPJ të tërhiqet, për arsye personale.

Në përfundim ju bëjmë me dije se Znj. J. H. nuk ka shërbyer asnjë ditë në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, si dhe nuk është pajisur me pasaportë diplomatike dhe nuk ka gëzuar për asnjë moment imunitetet dhe privilegjet që të jep statusi i diplomatit. Rrjedhimisht nuk ka patur asnjë komunikim me autoritetet turke për këtë emërim.

--	--	--	--	--	--	--